



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	20.08.2024
NR/BR.	265/24
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për shfuqizim të vendimit 01 nr. 79 të datës 25.05.2018

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 53, të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të merr:

V E N D I M

1. SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit Komunal me 01 nr. 79 i datës 25.05.2018.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 79
Datë: 25.05.2018

Në bazë të nenit 12, pika (d) , nenit 40 pika (c) të Ligjit nr. 03/L -040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) nenit 25 paragrafit 2 pika 2.3 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur me datën 18.05.2018 miratoi:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E PAGESËS PËR LEJE NDERTIMORE TË KATEGORISË II ME KATËR KËSTE

I

LEJOHET – Pagesa në 4 (katër) këste për leje ndërtimore të kategorisë II

II

Mënyra e pagesës së taksës komunale për dhënën e lejeve ndërtimore të kategorisë së II e cekur në pikën I të këtij vendimi bëhet:

- kësti i parë: 40% e vlerë së përgjithshme të paguhet para lëshimit të vendimit për leje ndërtimore;
- kësti dytë: 20% e vlerës së përgjithshme të paguhet 4 (katër) muaj pas datës së dhënës së leje ndërtimit;
- kësti tretë: 20% e vlerës së përgjithshme (pjesa e mbetur) 8 (tetë) muaj pas datës së dhënës së leje ndërtimit;
- Kësti katër: 20% e vlerës së përgjithshme të paguhet 12 (dymbëdhjetë) muaj pas datës së dhënës së leje ndërtimit;

III

Pagesa e kështit të dytë, të tretë dhe të katërt bëhet pasi pala bjen garancion bankar ose garanacion nga kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesja e KK-së

Kristina Gashi Bytyçi



Arsyetimi

Kuvendi i Komunës së Ferizajt me vendim numër 01. Nr.79, të datës 25.05.2018 ka nxjerrë vendim për lejimin e pagesës për leje ndërtimore të kategorisë II me katër këste.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, ka hasur në vështirësi të zbatimit të këtij vendimi në inkasimin e mjeteve financaiare dhe në mënyrë që mos të krijohen obligime të reja propozojm që ky vendim të shfuqizohet të përshkruar si në dispozitiv të këtij propozim vendimi.

Të bashkangjitur gjeni;

- *Vendimin e Kuvendit të Komunës me nr. 01. Nr.79 të datës 25.05.2018.*